



Në mbështetje të nenit 4,21,22 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189), neni 7 (pika 2.3 dhe 4) neni 15 (pika 1, 2 dhe 3) të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037), Udhëzimit Administrativ për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë (Nr. 25/2012), Udhëzimit Administrativ për Themelimin e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës (Nr. 11/2004), Udhëzimit Administrativ mbi Kriteret dhe Procedurat për Akreditimin e Shkollave të Larta Profesionale dhe Shkollave të Larta Teknike në Republikën e Kosovës (Nr. 12/2009), dhe Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë, në mbledhjen XXXIII-të të mbajtur më 07.07.2015, mori:

## V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht kërkesa e BPrAL SHLP “QEAP Heimerer” nr. 665/15, datë 16.07.2015, për rishqyrtim të vendimit të KSHC-së nr. 635/15, datë 13.07.2015.
- II. Anullohet pika II e vendimit të KSHC-së me nr. 635/15, datë 13.07.2015, për mos riakreditim të programit të studimit: Infermieri e përgjithshme, BA (180 ECTS), (me specializim, Infermieri e përgjithshme; Geriatri).
- III. Mbetet në fuqi vendimi i KSHC-së nr. 511/13, datë 08.07.2013 për akreditim të programit: Infermieri e përgjithshme, BA (180 ECTS).
- IV. Mbetet në fuqi vendimi i KSHC-së datë 13.07.2015, nr. 665/15, pika I dhe pika III.

## Arsyetim

Duke u bazuar në dispozitat e shënuara me lartë, kërkesën e BPrAL SHLP “QEAP Heimerer” nr. 665/15, datë 16.07.2015, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Vendimi u dërgohet:

- BPrAL SHLP “QEAP-Heimerer”;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



---

Dr.sc. Ferdije Zhushi Etemi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë